

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Si mund të përfundojnë në dënime të ngjashme dy anë të kundërta të historisë?
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/paradoksi-i-drejtësisë-nderkombetare-si-perfundojn-e-ne-denime-te-ngja-i586481
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 12:48:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 12:45:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ad486fe869df42c655e703a23ce0186e13e5a49ab46c108bbba70e01053b3c69
TEKSTI	6a22d8c043ecb3e1b3d2cff64cc6ea308b12545999148a0178aa0283c8405447
PAMJA	721fe8da76a72797a2d9871fc318a224373a1623b97f47252cb1cc7435378b57

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	86f363088f4c8cfbf570f32d052bcbb5f36dbcd4ac6cbcf278fbaf6e9c2ff727
E MËPARSHMJA	d129c3921b5f5944f8e55ed20bbf69e3a5c5b93efc4da3d3fbfa425de3a22de2
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/86f363088f4c8cfbf570f32d052bcbb5f36dbcd4ac6cbcf278fbaf6e9c2ff727>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

le Vendimet e qeverise/ Karakaçi: Rezerva e sigurise se hidrokarbureve do te menaxhohet nga shteti, nis puna per mbikalimet ne Kashar dhe YrshekKush eshte Charles Sr fundit

Si mund të përfundojnë në dënime të ngjashme dy anë të kundërta të historisë?



16 Shtator 2026, 14:45Blog Bjorn Runa

Ajo që ishte edhe më surprizuese në lidhje me verdiktin e sotëm të Gjykatës Speciale në Hagë është tronditja dhe befasia me të cilën shumë shqiptarë e përjetuan vendimin, duke harruar se këto tribunale u krijuan posaçërisht për të hetuar dhe gjykua një kategori shumë të ngushtë akuzash që lidhen me krimet e pretenduara gjatë dhe pas luftës në Kosovë. Vetë mandati i tyre është i përqendruar pikërisht te këto akuza. Ndaj është e vështirë të besohet se një mekanizëm i tërë special, i ngritur ndër vite për të hetuar, ndjekur penalisht dhe gjykuar pikërisht këto pretendime, do të përfundonte domosdoshmërisht me pafajësi të plotë për të gjithë figurat kryesore që u vunë përpara tij.

Nga ana tjetër, çka është e vështirë të kapërdihet është shkalla e dënimit të ish-krerëve të UÇK-së. Albert Speer, ministri nazist përgjegjës për armatimet dhe mbajtjen në këmbë të ekonomisë së luftës në Gjermaninë hitleriane, u dënua në procesin e Njrembergut me 20 vite burg. Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi u dënuan me 25 vite burg secili. Për dy udhëheqësit e tjerë të UÇK-së, ndonëse më të ulëta, dënimet janë sërish në ato kufij.

Katër burra të cilët përfaqësojnë krejt të kundërtën e asaj çka Speer përfaqësonte në Europën e shekullit të 20-të, të pozicionuar në luftë kundër një regjimi me synime thuajse identike me ato të nazistëve dhe që ndoshta vetëm mjetet i mungonin e jo vullneti për të qenë në një nivel me ta.

Nëse 20 vite ishte dënimi që u gjykua i drejtë ndaj një prej personave që mbajtën në këmbë ekonominë naziste të luftës, si duhet ta kuptojmë kur njerëz që udhëhoqën një përpjekje për liri, marrin dënime të ngjashme, e madje edhe më të rënda?

Teksa dëgjoje qasjen e trupës gjykuese në seancën e sotme, të krijonte përshtypjen se kanë një imagjinatë fëminore rreth luftës. Përpjekjet për liri nuk janë ngjarje neutrale, ku viktima ka luksin të përlllogarisë me kujdes çdo veprim të vetin. Aq më tepër në rastin e UÇK-së që, siç doli edhe nga dëshmitë e disa ish ushtarakëve të NATO-s të përfshirë në luftën e Kosovës, nuk ka qenë një organizatë me një strukturë të qartë komanduese, e aftë për të ndërmarre veprime të organizuara e të kalkuluar me hollësi.

Çfarëdo shpjegimi ligjor që të jepet, dënime kaq të gjata për ish krerët e UÇK-së, mbeten të vështira për t'u kapërdirë moralisht dhe historikisht.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Drejtësi apo turp? Shqiptarët janë dënuar për luftën me 150 vite burgim më shumë se serbët](#)

14:20 Blog / 2 komente

[Kur agresorët serbë shkruanin dosjen në Hagë, shqiptarët flinin mbi dafina](#)

13:35 Blog / 11 komente

[Pisa: mesuesi, nxenesi dhe inteligjenca artificiale](#)

12:55 Blog / 1 koment

[Duhet të kishim dhe ne shqiptarët qelitë tona në Hagë](#)

12:44 Blog



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.